

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 8091
E mërkurë, 9 korrik 2025
Çmimi 0.50 €

Vasfije Krasniqi në revistën
"Vogue" në mesin 250 të
mbijetuarave të dhunës
seksuale në gjithë botën

FACE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

MBI GJYSMË MILIONI EURO PËR NJË KUVEND QË NUK E KA NISUR PUNËN

FACE 5



Që nga 15 prilli, kur ka filluar seanca konstituive e Kuvendit, deputetët kanë përfituar dy paga e gjysmë, edhe pse shumica e 43 vazhdimëve kanë zgjatur vetëm disa minuta për shkak të mosmarrëveshjeve për zgjedhjen e kryeparlamentarit dhe

mënyrën e votimit. Deri tani 103 deputetë kanë marrë dy paga e gjysmë, ndërsa 17 të tjerë, që kanë mandatin e deputetit, por vazhdojnë të mbajnë funksione në qeverinë në detyrë të Kosovës, janë paguar nga ekzekutivi. Kostoja totale

për pagat e deputetëve, nga 15 prilli deri më 30 qershor, ka arritur në 478 mijë e 692 euro. Përveç pagave të tyre, buxheti i shtetit mbulon edhe pagat e zyrtarëve të lartë personalë të deputetëve, që ndryshe njihen si asistentë

**APELI I
SPECIALES
MË 14 KORRIK
SHPALL VENDIMIN
PËR PJETËR
SHALËN**

F.3



**KURTI: GJENOCIDI
NË SREBRENICË,
PLAGË E HAPUR E
EVROPËS, E VËRTETA
NUK DUHET
TË HARROHET**

F.5



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



**PDK-JA KËRKON DREJTËSI PËR
VËLLEZËRIT BYTYQI**

F.5

**MAQEDONCI PRET NË TAKIM
HOMOLOGUN ZVICERAN, THEKSOHET
RËNDËSIA E DIASPORËS DHE
BASHKËPUNIMIT USHTARAK NË MES
TË KOSOVËS DHE ZVICRËS**

F.3

**KONTRATA MILIONËSHE NGA SERBIA
PËR KOMPANINË E PËRFSHIRË NË
AKTAKUZËN PËR BANJSKËN**

F.7

EKONOMI



**ASK-ja: MBI 207 MIJË BANESA TË
BLERA, POR TË PABANUARA NË
KOSOVË**

F.8

**PECI: KOSOVA THYEN REKORD
NË MBJELLJEN E GRURIT,
MBI 74 MIJË HEKTARË
TË MBJELLA NË VITIN 2025**

F.8

SPORT



**DREJTORIA E SPORTIT NË
PRISHTINË, PAS BLOKIMIT TË
BUXHETIT: E PAMUNDUR MBËSHTETJA
FINANCIARE PËR SPORTISTËT**

F.10

Netanyahu nominon Trumpin për Çmimin Nobel për Paqe

UASHINGTON, 8 KORRIK - Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, ka bërë me dije se ka nominuar presidentin e Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, për Çmimin Nobel për Paqe. Netanyahu ka takuar Trumpin në Shtëpinë e Bardhë, ku ka thënë se i ka treguar letrën që i ka dërguar komitetit që ndan çmimin prestigjioz. “Ai po ndërton paqe ndërkohë që ne flasim, në një vend... në një rajon pas tjetrit”, ka thënë Netanyahu gjatë një darke me Trumpin në Shtëpinë e Bardhë. Gjatë viteve, Trumpi është

nominuar disa herë për Çmimin Nobel për Paqe nga mbështetës dhe ligjvënës të ndryshëm dhe nuk e ka fshehur zhgënjimin e tij që nuk ka fituar. Ai është ankuar hapur se është anashkaluar nga Komiteti Norvegjez i Çmimit Nobel për rolin e tij ndërmjetësues në konfliktet midis Indisë dhe Pakistanit, si dhe Kosovës dhe Serbisë. Në vitin 2020, derisa Trumpi ka shërbyer në mandatin e parë presidencial, ai ka dëshmuar nënshkrimin e një marrëveshjeje mes Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e

marrëdhënieve ekonomike. Muajin e kaluar, Trumpi i është bashkuar luftës së Izraelit në Iran, duke sulmuar objektet bërthamore iraniane. Më pas, ai ka ndërmjetësuar një marrëveshje armëpushimi mes këtyre dy vendeve. Paraardhësi i Trumpit gjatë mandatit të parë, Barack Obama, ka fituar Çmimin Nobel për Paqe në vitin 2009. Komiteti Norvegjez i Nobelit ka përmendur “përpjekjet e tij të jashtëzakonshme për të forcuar diplomacinë ndërkombëtare dhe bashkëpunimin midis popujve” si arsye për çmimin.



Numri i të vdekurve nga përmytjet në Teksas, mbi 100

Uashington, 8 korrik - Numri i të vdekurve nga përmytjet e papritura që kanë goditur Teksasin qendror në ShBA, të premtën e kaluar, ka kaluar mbi 100. Një numër ende i panjohur personash vazhdojnë të mbeten të zhdukur. Ekipet emergjente vazhdojnë kërkimet nëpër brigjet e lumenjve të mbuluara me baltë, ndonëse shpresat për të gjetur të mbijetuar janë duke u zvogëluar. Kampi Mystic, një kamp veror vetëm për vajza, ka konfirmuar se së paku 27 vajza dhe anëtarë të stafit janë në mesin e të vdekurve. Dhjetë vajza të tjera dhe një këshilltar nuk janë gjetur ende. Në Qarkun Kerr, ku edhe ndodhej kampi, kanë vdekur së paku 84 persona, 56 të rritur dhe 28 fëmijë pasi lumi Guadalupe është mbushur me ujë nga shirat e rrëmbyeshëm duke përmytur zonën. Rreth 22 të rritur dhe 10 fëmijë nuk janë identifikuar ende, ka njoftuar policia e qarkut. Shtëpia e Bardhë, ndërkohë, i ka



hedhur poshtë deklaratat e disa kritikëve se shkurtime buxhetore në Shërbimin Kombëtar të Motit (NWS) mund

ta kenë penguar reagimin ndaj katastrofës. “Ky ishte një veprim i Zotit. Nuk është faji i administratës që përmytja

ndodhi në atë kohë... Kishte paralajmërime të hershme dhe të vazhdueshme dhe, prapëseprapë, Shërbimi

Kombëtar i Motit e bëri punën e vet”, ka thënë sekretarja e shtypit e Shtëpisë së Bardhë, Karoline Leavitt.

Pse përmytjet në Teksas ishin aq shkatërruese?

EEkspertët kanë thënë se janë disa faktorë që kanë kontribuar në këtë tragjedi, përfshirë: motin ekstrem, vendndodhjen e shtëpive dhe kohën. Në atmosferë kishte një sasi të madhe lagështie nga një stuhi tropikale, që kishte shkaktuar përmytje në Meksikë dhe më pas ishte drejtuar drejt veriut, duke u shuar gradualisht. Qarku Kerr, ku kanë humbur jetën 84 persona, është një zonë më kodrinore se qarqet e tjera përreth në Teksas. Kjo ka bërë që ajri me lagështi të ngrihej lart dhe të krijonte re të mëdha stuhie. Këto re ishin aq të mëdha sa që janë bërë një sistem i veçantë moti, duke shkaktuar reshje të dendura shiu në një zonë të gjerë.

Turqia paraqet robotin inteligjent për zbulimin e minave

STAMBOLL, 8 KORRIK - Kompanitë turke të mbrojtjes “Mesan Electronics” dhe “Esetron” kanë zhvilluar së bashku një robot pa pilot të projektuar për të zbuluar mina dhe pajisje shpërthyes të improvizuara (IED), të cilin e kanë prezantuar në Panairin Ndërkombëtar të Industrisë së Mbrojtjes (IDEF 2025) në Stamboll. Duke vepruar në mënyrë autonome ose nga distanca, roboti kombinon teknologjitë e përparuara të sensorëve të kompanisë “Mesan

Electronics” dhe platformën kompakte dhe të qëndrueshme të robotit të kompanisë ‘Esetron’ për të zbuluar mina anti-personel dhe anti-tank, IED, kablllo, tela shkrehës dhe linja shkrehëse. Koka e skanimit mund të ndërrohet sipas nevojave operacionale, duke u lejuar forcave të sigurisë të kryejnë operacione efektive zbulimi në zona të rrezikshme dhe me më pak mundësi për të shkaktuar viktima, raportojnë mediet turke.

Sistemi është zhvilluar për t’u përdorur në operacione përtej kufirit, në përpjekjet kundër terrorizmit, në pastrimin e minave dhe në sigurimin e perimetrit të posteve ushtarake. Roboti i lehtë ka një dizajn modular dhe mund të transportohet nga një person i vetëm dhe të përshtatet shpejt për t’u përdorur në lloje të ndryshme misionesh. Vendet afrikane, të Lindjes së Mesme dhe të Ballkanit kanë treguar kërkesë të fortë për produktin, duke zbuluar potencialin e tij të



eksportit. Dërgesat e para të sistemit robotik janë

planifikuar të bëhen për njësitë turke të sigurisë këtë vit.

VASFIJE KRASNIQI NË REVISTËN “VOGUE” NË MESIN 250 TË MBIJETUARAVE TË DHUNËS SEKSUALE NË GJITHË BOTËN

PRISHTINË, 8 KORRIK - Ka plagë aq të thella sa gjuha i lë pas dore. Përdhunimi është një prej tyre. Ai hesht me forcë dhe pastaj me turp - duke i lënë të mbijetuarat të izoluar jo vetëm në dhimbjen e tyre, por edhe në pamundësinë e tyre të perceptuar për të folur për të. “Le të flasim për përdhunimin”, projekti afatgjatë nga fotografia dhe aktivistja Jadëiga Brontë, përballet me atë heshtje me qartësi radikale, duke krijuar një hapësirë ku dëshmia, solidariteti dhe dukshmëria bashkohen, shkruan “Vogue”. Në mesin e shumë grave nga e gjithë bota, në këtë projekt të “Vogue” është përfshirë edhe Vasfije Krasniqi Goodman nga Kosova. Një nga zërat më të guximshëm të të mbijetuarave të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, shfaqet në revistën “Vogue” në kuadër të projektit

ndërkombëtar “Let’s Talk About Rape”. Ky projekt i fuqishëm i fotografes Jadwiga Brontë sjell në fokus historitë e grave që kanë përjetuar traumë, duke i ndihmuar ato ta rikthejnë kontrollin mbi narrativën e tyre përmes artit dhe vetëprezentimit. Vasfije ishte vetëm 16 vjeçe kur është rrëmbyer dhe dhunuar nga forcat serbe gjatë luftës së viteve '90 në Kosovë. Për vite më radhë ajo kishte mbetur në heshtje, si shumë gra të tjera që u përballën me të njëjtën dhimbje. Por në vitin 2015 ajo ka vendosur të fliste publikisht, duke u bërë gruaja e parë shqiptare nga Kosova që dëshmoi hapur për dhunën seksuale të përjetuar gjatë luftës. Që nga ajo ditë ajo është kthyer në një simbol të rezistencës dhe kurajës, duke u bërë zë për ata që ende nuk mund të flasin.



MAQEDONCI PRET NË TAKIM HOMOLOGUN ZVICERAN, THEKSOHET RËNDËSIA E DIASPORËS DHE BASHKËPUNIMIT USHTARAK NË MES TË KOSOVËS DHE ZVICRËS

PRISHTINË, 8 KORRIK - Ministri në detyrë i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, i shoqëruar nga zëvendësministri në detyrë, Shemsi Sylja, dhe sekretari i përgjithshëm në këtë ministri, Gafurr Dugolli, kanë pritur në takim kancelarin federal dhe ministrin e Mbrojtjes, Mbrojtjes Civile dhe Sportit të Zvicrës, Martin Pfister, të shoqëruar nga delegacioni i tij. Ministri Maqedonci ka theksuar rolin kyç të diasporës sonë në Zvicër si një urë lidhëse mes dy vendeve, duke kontribuar në forcimin e marrëdhënieve bilaterale dhe zhvillimin e vendit tonë. “Në takim u diskutua për mundësitë e bashkëpunimit në fushën e trajnimeve dhe edukimit ushtarak - një hap i



rëndësishëm drejt rritjes së kapaciteteve mbrojtëse të Forcës së Sigurisë së Kosovës”, ka njoftuar Ministria e Mbrojtjes. Gjithashtu, ministri Maqedonci e ka informuar homologun zviceran për arritjet e FSK-së ndër vite dhe ka theksuar rëndësinë strategjike të anëtarësimit të Kosovës në Bashkimin Evropian dhe NATO, si garanci për stabilitetin e qëndrueshëm në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Të dy ministrat janë pajtuar për thellimin e bashkëpunimit në fusha me interes të përbashkët, duke konfirmuar përkushtimin e ndërsjellë për një të ardhme më të sigurt dhe më të qëndrueshme.

Apeli i Speciales më 14 korrik shpall vendimin për Pjetër Shalën

HAGË, 8 KORRIK - Gjykata e Apelit në Dhomat e Specializuara në Hagë ka njoftuar se më 14 korrik 2025, në orën 11:30, do ta shpallë aktgjykimin në çështjen ndaj Pjetër Shalës, ish-pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Ky vendim pritet me interes të lartë publik, pasi më 16 korrik 2024 Pjetër Shala ishte shpallur fajtor për krime lufte dhe ishte dënuar me 18 vjet burgim. Ai ishte “gjetur

fajtor” për ndalim arbitrar, torturë dhe vrasje, në një rast që përfshinte vdekjen e një të ndaluarit në një qendër ndalimi në Kukës gjatë vitit 1999. Shala ishte shpallur i pafajshëm për akuzën e “trajtimit mizor”, pasi gjykata e kishte përfshirë atë në kuadrin e veprës penale të torturës. Dënimi është shqiptuar në një masë të vetme prej 18 vjetësh burgim, që përfshin të gjitha

akuzat për të cilat u shpall fajtor. Vendimi i Apelit më 14 korrik do të përcaktojë nëse ky dënim do të konfirmohet, reduktohet apo ndryshohet, pas ankesës së paraqitur nga mbrojtja. Ky është një nga rastet më të rëndësishme që po trajton drejtësia ndërkombëtare në lidhje me luftën në Kosovë, dhe vendimi i Apelit pritet të ketë jehonë të madhe në publik dhe medie.



MBI GJYSMË MILIONI EURO PËR NJË KUVEND QË NUK E KA NISUR PUNËN

Që nga 15 prilli, kur ka filluar seanca konstituive e Kuvendit, deputetët kanë përfituar dy paga e gjysmë, edhe pse shumica e 43 vazhdimëve kanë zgjatur vetëm disa minuta për shkak të mosmarrëveshjeve për zgjedhjen e kryeparlamentarit dhe mënyrën e votimit. Deri tani 103 deputetë kanë marrë dy paga e gjysmë, ndërsa 17 të tjerë, që kanë mandatin e deputetit, por vazhdojnë të mbajnë funksione në qeverinë në detyrë të Kosovës, janë paguar nga ekzekutivi. Kostoja totale për pagat e deputetëve, nga 15 prilli deri më 30 qershor, ka arritur në 478 mijë e 692 euro. Përveç pagave të tyre, buxheti i shtetit mbulon edhe pagat e zyrtarëve të lartë personalë të deputetëve, që ndryshe njihen si asistentë

PRISHTINË, 8 KORRIK - Pa kryer asnjë punë, deputetët e zgjedhur të Kuvendit të Kosovës dhe asistentët e tyre po i kushtojnë buxhetit të shtetit qindra mijëra euro. Tashmë dyzet e tri përpjekje për të konstituuar Kuvendin, kanë dështuar. Për disa deputetë të rinj kjo situatë është shumë larg pritshmërive të tyre.

Nezir Krakit, bllokimi i konstituimit të Kuvendit po ia vështirëson punën dhe angazhimin si ligjvënës. Ai është zgjedhur për herë të parë në zgjedhjet e 9 shkurtit si deputet i partisë Guxo - pjesë e koalicionit me Lëvizjen Vetëvendosje dhe Alternativën, që ka fituar shumicën e votave. Mandatin e deputetit të Kuvendit të Kosovës, ka thënë se e ka marrë për të kontribuar në jetën politike dhe parlamentare si ligjvënës, “e jo kot së koti”.

Kraki dhe deputetët e tjerë të zgjedhur - 120 gjithsej - marrin paga sikur Kuvendi të ishte funksional. Që nga 15 prilli, kur ka filluar seanca konstituive, ata kanë përfituar dy paga e gjysmë, edhe pse shumica e 43 vazhdimëve kanë zgjatur vetëm disa minuta, për shkak të mosmarrëveshjeve mbi zgjedhjen e kryeparlamentarit dhe mënyrën e votimit. Deri tani 103 deputetë kanë marrë dy paga e gjysmë, ndërsa 17 të tjerë, që kanë mandatin e deputetit, por vazhdojnë të mbajnë funksione në qeverinë në detyrë të Kosovës, janë paguar nga ekzekutivi.

Kostoja totale për pagat e deputetëve, nga 15 prilli deri më 30 qershor, ka arritur në 478 mijë e 692 euro. Përveç pagave të tyre, buxheti i shtetit mbulon edhe pagat e zyrtarëve të lartë personalë të deputetëve, që ndryshe njihen si asistentë.

“A e keni pritur ju, për shembull, që konstituimi i Kuvendit do të zgjasë gjashtë muaj?”

“Radio Evropa e Lirë” ka pyetur në Kuvendin e Kosovës se sa asistentë janë të angazhuar aktualisht dhe çfarë vlere kapin pagat e tyre, por që nuk nga fundi i javës së kaluar, nuk ka marrë përgjigje.

Në qershor mediet në Kosovë raportuan se deputetët e zgjedhur kanë angazhuar deri



në atë kohë 74 asistentë personalë. Njëra prej tyre, deputetja Time Kadrijaj nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), ka thënë për “Radion Evropa e Lirë” se ky angazhim është bërë në përputhje me Rregulloren e Kuvendit dhe Ligjin për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit. Sipas saj, asistentët janë emëruar me pritjen se Kuvendi do të konstituohet shpejt dhe se do ta nisin menjëherë punën e tyre parlamentare.

“A e keni pritur ju, për shembull, që konstituimi i Kuvendit do të zgjasë gjashtë muaj? Askush nuk e ka pritur. Duke menduar që si parti më e madhe, (Lëvizja Vetëvendosje) do ta konstituojë Kuvendin shumë shpejt, ne i jemi përmbytur rregullores së Kuvendit. Tash ne nuk mund t’u themi (asistentëve) të shkojnë në shtëpi se nuk është konstituuar Kuvendi. Nuk mund të bëjmë as shkelje të rregullores dhe as të ligjit”, ka thënë Kadrijaj.

E pyetur se cili është roli i asistentit të saj në këtë situatë, Kadrijaj është përgjigjur: “Nëpër debate në televizione më nevojiten për shembull: statistika, data, materiale për aferat korruptive... më ndihmojnë. U them: më duhet kjo ose kjo, dhe më

ndihmojnë”.

Kadrijaj ka thënë se nuk e di se sa është paga e asistentit të saj. Por, sipas Rregullores për Shtesa mbi Pagën Bazë për Deputetë dhe për Klasifikimin e Pagës për Stafin Mbështetës Politik të Kuvendit të Republikës së Kosovës, asistenti i deputetit ka pagë bazë me koeficient 5.8 dhe përfiton shtesë prej 30-përqindësh të kësaj page. Kjo i bie që një asistent, në qershor për shembull, ka marrë pagë bazë prej 638 eurosh, ndërsa me shtesat e parashikuara në rregullore, kjo shumë ka shkuar në rreth 900 euro.

“Paga të pamerituara”

Deputeti Kraki ka thënë se ai dhe kolegët e tij kanë të drejtë ligjore në pagën e tyre, por thekson se ajo nuk e bën të ndihet mirë derisa nuk e ushtron detyrën siç duhet. “Është një shpenzim edhe i energjisë fizike prej nesh, por edhe në mënyrë financiare nga ana e Kuvendit, si kot së koti”, ka thënë ai për “Radion Evropa e Lirë”.

Pa dhënë shumë detaje, Kraki ka thënë se ka bërë përpjekje t’i bindë kolegët që të gjejnë zgjidhje dhe ta tejkalojnë bllokadën që po e pengon konstituimin e Kuvendit, por pa sukses.

Si Kraki, edhe Kosovare Murseli është zgjedhur për herë të parë deputete në zgjedhjet e 9 shkurtit, por ajo vjen nga tabori tjetër - Partia Demokratike e Kosovës (PDK), që aktualisht është në opozitë. Ajo ka thënë për “Radion Evropa e Lirë” se pamundësia për të ushtruar rolin e deputetes në mënyrë efektive, i ka shkakuar ndjenjë të thellë zhgënjimi. Gjithashtu, ka treguar se për periudhën 15 prill - 30 qershor ka marrë dy paga e gjysmë si deputete. “Në kushte normale, paga e një deputeti, e them me sinqeritetin më të madh, është përgjegjësi dhe jo privilegj - personalisht për mua. Mirëpo, në këto rrethana, kur Kuvendi nuk është konstituuar dhe nuk po na lejohej ta ushtrojmë mandatin që na e ka dhënë populli, kjo pagë është e pamerituar. Unë, personalisht, nuk ndihem mirë”, ka thënë Murseli.

“Paga edhe me rritje”

Blendi Hasaj, drejtor ekzekutiv i Institutit për Hulumtime të Avancuara GAP në Prishtinë, ka thënë se pagat e deputetëve nuk mund të kontestohen ligjërisht. Megjithatë, ai ka vlerësuar se kostoja e tyre është e lartë dhe moralisht e pajustificueshme, pasi

deputetët nuk kanë bërë përpjekje serioze për të tejkaluar bllokadën në konstituimin e Kuvendit. “... sidomos kur disa nga ta nuk kanë hezitur të angazhojnë edhe asistentë, të cilët nuk e kryejnë asnjë funksion apo ndihmë për ta për momentin, marrë parasysh që vetë Kuvendi është i bllokuar dhe nuk është duke proceduar me leximin apo përgatitjen për trajtimin e ndonjë projektligji të ri”, ka thënë Hasaj.

E kostoja e shpenzimeve mujore për pagat e deputetëve dhe të asistentëve, nga korriku pritet të jetë edhe më e lartë. Kjo për shkak se Qeveria e Kosovës, në nëntor të vitit të kaluar, ka vendosur që pagat në sektorin publik të rriten për 55 euro nga janari i vitit 2025 dhe për 55 euro të tjera nga korriku. “Ndonëse nuk janë duke kryer ndonjë punë - nuk mund të them funksion - në Kuvend, tash e marrin edhe pagën me rritje. Rritja e pagës në ekonomi duhet të pasqyrojë rritjen e produktivitetit, por në këtë rast nuk ndërlidhet...”, ka thënë Hasaj.

Në buxhetin e shtetit, nga i cili paguhet deputetët dhe asistentët e tyre, kontribuojnë edhe qytetarët me pagesën e taksave. Në disa anketa që ka zhvilluar “REL”-i, qytetarët kanë thënë se duan zgjidhje përmes dialogut politik.

Sot (e mërkurë) do të tentohet për herë të 43 të konstituohet legjislatura e nëntë parlamentare. Kujtojmë se partitë ish-opozitare, përfshirë PDK-në, LDK-në, AAK-në, Nismën dhe Listën Serbe janë duke refuzuar të propozojnë anëtarë për komisionin që do të organizonte votimin e fshehtë për kryeparlamentarin, duke e konsideruar këtë proces si të papajtueshëm me Kushtetutën.

Në votim të hapur, ata e kanë kundërshtuar disa herë radhazi emërimin e Albulena Haxhiut nga Lëvizja Vetëvendosje në këtë pozitë. Vetëvendosje, e cila ka fituar shumicën e votave në zgjedhjet parlamentare të shkurtit, këmbëngul se votimi i fshehtë është legjitim dhe kërkon të ecet përpara.

Përndryshe, nga 26 qershori, deputetët i obligon edhe një vendim i Gjykatës Kushtetuese për ta konstituuar Kuvendin në një afat prej 30 ditësh, por, deri më tash, nuk duket se ka vullnet politik për ta zbatuar atë.

KURTI: GJENOCIDI NË SREBRENICË, PLAGË E HAPUR E EVROPËS, E VËRTETA NUK DUHET TË HARROHET

PRISHTINË, 8 KORRIK - Në 30-vjetorin e gjenocidit në Srebrenicë, shtëpia botuese "Dituria Islame" e Bashkësisë Islame të Kosovës ka botuar veprën "Dëshmitar i gjenocidit në Srebrenicë" të autorit Mevludin Hrniq, i mbijetuar i kësaj masakre. Në promovimin e këtij libri ka marrë pjesë edhe kryeministri në detyrë, Albin Kurti. Me këtë rast, Kurti ka thënë se "çdo dëshmi që ndriçon të vërtetën është gur kujtese dhe përgjegjësi që nuk mund të harrohet". Në këtë kontekst, Kurti ka rikujtuar vendimin e Qeverisë së Kosovës për të shpallur 11 korrikun Ditë Memoriale për Gjenocidin në Srebrenicë.

"Sot në zemër të Prishtinës ne po kujtojmë një plagë të hapur të Evropës. Libri 'Dëshmitar i gjenocidit te Srebrenicës', më shumë se një rrëfim personal është gurë kujtese me një plagë që ende kullon. Në heshtjen pas gjenocidit çdo fjalë që të tregon të vërtetën që ndriçon të vërtetën. Ishte gjenocid dhe ky gjenocid është krim që i përket të gjithë njerëzimit dhe përgjegjësi që nuk mund të harrohet. Sikur boshnjakët edhe shqiptarët e Kosovës përjetuan egërsinë dhe mizorinë nga i njëjti pushtues. Kur u bëra kryeministër e sollëm këtë

kujtim edhe në institucione, duke njohur vuajtjet e popullit boshnjak e miratuam një rezolutë dhe e shpallëm 11 Korrikun, Ditë Memoriale për gjenocidin e Srebrenicës. Çdo dëshmitar dhe çdo libër është dëshmi që duhet respektuar dhe afirmuar. Falënderoj që ky zë të jetë edhe në gjuhën shqipe dhe për të besuar se e vërteta sado e vonuar gjithmonë mund të flasë", ka thënë Kurti.

Ndërsa kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, myftiu Naim Tërnavë, ka theksuar se e vërteta nuk vdes dhe nuk hesht dhe se vepra është homazh për viktimat, por edhe një thirrje për drejtësi dhe parandalim të tragjedi në të ardhmen. "Sot në përvjetorin e 30-të jemi mbledhur, jo vetëm për të kujtuar, por edhe për të dëshmuar që e vërteta nuk vdes dhe nuk hesht. Promovimi i këtij botimi realizohet sot si homazh dhe si shprehje e kujdesit dhe përgjegjësisë morale ndaj historisë sonë. Mbi 8 mijë burra dhe djem u masakruan dhe shumë gra u dhunuan dhe shumë të tjerë u shpërngulën. U krye në një vend të siguar nga OKB-ja. Populli shqiptar tregoi qëndresë dhe dinjitet dhe vazhdon të ruhen përmes kujtimeve dhe dëshmi të të



mbijetuarve. Për lexuesit shqiptarë kjo vepër hedh dritë dhe nxit nevojë për kujtesën dhe që të reflektojmë. Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës do të mbështes në të ardhmen projekte të tilla për vendosjen e drejtësisë dhe parandalimin e tragjedi në të ardhmen. E kaluara e harruar rrezikon të përsëritet", ka thënë Tërnavë. Në anën tjetër, redaktori i librit "Dëshmitar i gjenocidit

në Srebrenicë", Ramadan Shkodra, ka vlerësuar se libri përçon një dëshmi autentike që nuk lë vend për dyshim dhe është një kujtesë kundër harresës. "Nuk jemi këtu për të promovuar një ditë, që për nga pesha është e veçantë. Jemi këtu për të mos harruar dhe për të treguar një dëshmi dhe të mos mbulohet nga pluhuri i harresës. Kujtojmë një nga krimet më të tmerrshme: gjenocidin e Srebrenicës. Më shumë se 8

mijë burra u masakruan në mënyrë sistematike. Kjo ndodhi në një vend, ku ishte garantuar e sigurt. Është provë kur urrejtja bëhet ideologji. Sot më shumë se kurrë kemi nevojë të kujtojmë dhe të flasim. Ky libër ka për qëllim që lexuesit të marrin dëshminë drejt, që nuk lënë vend për dyshime. Libri është një homazh për viktimat, por edhe një thirrje që të mos ndodhin krime të tilla", ka thënë Shkodra.

PDK-ja KËRKON DREJTËSI PËR VËLLEZËRIT BYTYQI

PRISHTINË, 8 KORRIK - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka përkujtuar vëllezërit Bytyqi në 26-vjetorin e ekzekutimit të tyre nga shteti serb. Kjo parti ka theksuar se vëllezërit Bytyqi janë mishërim i atdhedashurisë së pastër. Më tutje, PDK-ja ka thënë se Kosova dhe institucionet e saj kanë një detyrë të pazëvendësueshme: të mos ndalen kurrë në kërkim të drejtësisë derisa autorët e këtij krimi shtetëror të vihen para drejtësisë dhe ta marrin dënimin e merituar.

"Në 26-vjetorin e ekzekutimit të tyre nga shteti serb, me pamendim dhe gjakftohësi shtetërore - kujtojmë me nderim të thellë tre heronj, tre vëllezër: Mehmet, Agron dhe



Yll Bytyqi. Vëllezërit Bytyqi janë mishërim i atdhedashurisë së pastër. Me bekimin e prindërve, ata lanë pas jetën e qetë dhe të sigurt në ShBA, për të marrë rrugën e lavdisë në çlirimin e Kosovës,

aty ku liria u thërriste. Si pjesëtarë të Batalionit 'Atlantiku' në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ata dhanë kontribut të jashtëzakonshëm dhe patën fatin ta përjetojnë çlirimin - por jo pa e paguar

çmimin më të rëndë. Populli i Kosovës do të mbetet përjetësisht mirënjohës ndaj familjes Bytyqi për sakrificën e pashoqe. Ndërsa Kosova dhe institucionet e saj kanë një detyrë të pazëvendësueshme: të mos ndalen kurrë në kërkim të drejtësisë, derisa autorët e këtij krimi shtetëror të vihen para drejtësisë dhe të marrin dënimin e merituar. Lavdi e përjetshme Mehmetit, Agronit dhe Yllit!", është thënë në reagimin e PDK-së që drejtohet nga Memli Krasniqi.

Edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka përkujtuar vëllezërit Bytyqi. "Agron, Yll dhe Mehmet Bytyqi, shtetas amerikanë, si shumë vëllezër e motra shqiptarë kishin lënë ëndrrën amerikane për t'iu

bashkuar Ushtrisë Çlirimtare më kohën më vendimtare për atdheun. Luftuan me nder për lirinë e Kosovës, duke dëshmuar trimëri të pashoq, por përfunduan të vranë mizorisht nga dora kriminale e shtetit serb. Shteti serb përpos që i ekzekutoi, vazhdon me injorimin e krimeve dhe me dekorimin e kriminelëve të luftës, mes tyre edhe ata që dyshohen se vranë vëllezërit Bytyqi. Sot e çdo ditë ne ndajmë dhembjen e krenarinë me familjen Bytyqi, me bacën Ahmet e me zonjën Bahrije dhe bashkëluftëtarët e 'Atlantikut'. Dhembja e tyre është dhembja jonë. Krenaria për djemtë e tyre është krenari për mbarë kombin. Lavdi jetës dhe veprës së tyre!", ka thënë Haradinaj.

Kosova dhe Luksemburgu nënshkruajnë memorandum mirëkuptimi

Prishtinë, 8 korrik - Kosova dhe Luksemburgu kanë nënshkruar memorandum të mirëkuptimit. Marrëveshja është nënshkruar nga zëvendëskryeministri i parë në detyrë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Republikës së Kosovës, Besnik

Bislimi dhe zëvendëskryeministri, njëherësh ministër për Punë të Jashtme, Shkëmbim Tregtar dhe Bashkëpunim të Luksemburgut, Xavier Bettel. Përmes kësaj marrëveshjeje Luksemburgu do të vazhdojë ta rrisë mbështetjen e tij financiare

për Kosovën. Për periudhën 2026-2030 kjo mbështetje do të arrijë vlerën prej 50 milionë eurosh krahas 35 milionë eurove në marrëveshjen paraprake. Marrëveshja është nënshkruar në kuadër të takimit të 10

bilateral Kosovë - Luksemburg. Ajo përfshin si prioritetet dhe sektorë kyçë shkathtësitë për punësim të qëndrueshëm, shëndetësinë, rritjen e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, si dhe fuqizimin e shoqërisë civile të Kosovës.



Temperaturat e larta, IKShPK-ja bën thirrje për kujdes nga helmimet ushqimore

PRISHTINË, 8 KORRIK - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka alarmuar për rritje të rrezikut të helmimeve ushqimore për shkak të temperaturave të larta. “Siguria ushqimore u referohet të gjitha rreziqeve të cilat mund t’i shkaktojnë dëme ushqimit dhe përmes tij, shëndetit të popullatës. Në verë për shkak të temperaturave të larta rritet rreziku i helmimeve ushqimore. Mikroorganizmat shumohen më shpejt dhe ushqimi prishet më lehtë. Prandaj, kujdesi gjatë përgatitjes dhe ruajtjes së ushqimit është shumë i

rëndësishëm për të shmangur sëmundjet”, ka njoftuar IKShPK-ja. Sipas këtij njoftimi, IKShPK-ja ka vlerësuar se kontaminimi i ushqimeve mund të vijë nga duart e papastrat, ushqimet, uji, kafshët shtëpiake, insektet etj. Më tutje, IKShPK-ja ka theksuar se ushqimi duhet të gatuhet mirë dhe të konsumohet menjëherë pas përgatitjes. “Ruajeni ushqimin në mënyrë të sigurt: më të nxehtë mbi 60 gradë celsius, në frigorifer nën 5 gradë celsius. Mishi i ngrirë dhe mishi i shpendëve duhet të shkrihen tërësisht përpara gatimit. Ringroheni mirë

ushqimin e ruajtur: para konsumit, sigurohuni që ushqimi të arrijë përsëri 70 gradë celsius. Shmangni kontaktin mes ushqimit të papërpunuar dhe atij të gatuar: Përdorni thika dhe dërrasa të ndara për secilin. Lani duart shpesh dhe si duhet: para dhe pas përgatitjes së ushqimit, pas tualetit, pas ndërrimit/pastrimit të foshnjave apo pas kontaktit me kafshë. Mbani pastër kuzhinën dhe enët: pecetat dhe leckat ndërroni rregullisht dhe ziejini nëse kontaminohen. Mbroni ushqimin nga insektet dhe brejtësit: mbajeni ushqimin në enë të mbyllura



me kapak. Përdorni ujë të pastër dhe të sigurt: Nëse dyshoni në cilësinë e ujit, vlojeni para përdorimit. Kontrolloni datat e skadimit dhe freskinë: shmangni produktet

me erë apo pamje të pazakontë. Kujdes me ushqimin jashtë shtëpisë: përdorni frigoriferë dore ose enë termoizoluese në piknik apo udhëtime”, ka njoftuar IKShPK-ja.

POLICIA ARRESTON PESË ZYRTARË POLICORË LIDHUR ME INCIDENTIN NË LIPJAN KU VDIQ NJË I RI

PRISHTINË, 8 KORRIK - Policia e Kosovës i ka arrestuar pesë zyrtarë të saj lidhur me ndërhyrjen e tyre në një incident në Lipjan ku ka vdekur i riu Agon Zejnullahu, ka bërë me dije Inspektorati Policor i Kosovës (IPK). Mediet kanë raportuar se zyrtarët policorë dyshohen për kryerje të veprës penale “vrasje nga pakujdesia”. Arrestimi i tyre vjen pas rekomandimit të IPK-së që policia të vendosë masën e suspendimit të përkohshëm për pesë zyrtarët policorë të përfshirë në ndërhyrje.

“Me autorizim të Prokurorisë Themelore në Prishtinë janë ftuar për intervistim në IPK në cilësinë e të dyshuarve pesë zyrtarët policorë të përfshirë në këtë ndërhyrje/reagim policor (një rreshter dhe katër zyrtarë policorë)”, ka thënë IPK-ja përmes një komunikate, dhe që masa e ndalimit ndaj zyrtarëve është për 48 orë.

Policia e Kosovës ka thënë se personi i vdekur dyshohej se ishte nën ndikimin e alkoolit dhe po sulmonte automjete dhe kalimtarë në Lipjan.

Sipas zyrtarëve policorë, në vendngjarje është thirrur edhe ekipi mjekësor emergjent i cili ka ofruar ndihmën e parë, por që, përkundër përpjekjeve,



është konstatuar se ai ka ndërruar jetë. Në komunikatën për medie të lëshuar nga Inspektorati Policor i Kosovës është thënë se ky institucion ka nisur të mbledhë prova materiale, incizime të kamerave të sigurisë dhe që në hetim do t'i përfshijë edhe rezultatet e ekzaminimeve përfshirë ato mjeko-ligjore.

Ky institucion ka thënë se rastin do ta trajtojë si “hetim mbi vdekjen”. Pjesëtarë të shoqërisë civile, por edhe të partive politike kanë shprehur shqetësim për rastin dhe kanë kërkuar zbardhjen e së vërtetës.

Ehat Miftaraj, drejtor ekzekutiv i Institutit të Kosovës për Drejtësi, ka thënë përmes një postimi në “Facebook” se “mënyra se si pesë policë e menaxhuan këtë situatë më së paku mund të quhet pakujdesi dhe amatorizëm i skajshëm, 27-vjeçari vdiq në dorë të shtetit”. Ai ka kërkuar llogari nëse policët e përfshirë në incident kishin trajnim profesional për të menaxhuar situata të tilla, dhe nëse incidenti është rezultat “i politikave të reja të Lëvizjes Vetëvendosje që policët e rinj nga shkollat e mesme të bëhen policë me një trajnim prej vetëm 12 javësh”.

“Vrasja nga pakujdesia” e 27-vjeçarit në Lipjan, Sveçla: Jam thellësisht i prekur nga vdekja, pres të zbardhet e vërteta

Ministri në detyrë i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka reaguar për vdekjen e Agon Zejnullahut në Lipjan. Ai ka thënë se ka kërkuar angazhim urgjent dhe profesional nga IPK-ja dhe bashkëpunim të plotë të Policisë së Kosovës gjatë këtij hetimi. “Jam thellësisht i prekur nga lajmi për vdekjen e qytetarit tonë para mëngjesit të djeshëm në Lipjan. Si Ministër i Punëve të

Brendshme, sapo jam informuar për ngjarjen, kam kërkuar angazhim urgjent dhe profesional nga Inspektorati Policor i Kosovës si dhe bashkëpunim të plotë të Policisë së Kosovës gjatë këtij hetimi. Në kuadër të kësaj, hetimet tashmë janë duke u zhvilluar me intensitet maksimal. Bashkëpunimi mes Policisë së Kosovës, Inspektoratit Policor, Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe Prokurorisë është kyç për zbardhjen e plotë të rrethanave të kësaj ngjarjeje të rëndë”, ka thënë ai.

Sveçla u ka shprehur ngushëllime familjarëve të të ndjerit. Ai ka shtuar se askush nuk është mbi ligjin, dhe kushdo që rezulton fajtor do të përballet me drejtësinë dhe do ta marrë dënimin e merituar. Ai ka thënë se besimi në polici duhet ruajtur me çdo kusht dhe pa kursyer askënd pasi besimi qytetar është jo vetëm vlerë, por domosdoshmëri për punën e suksesshme të Policisë së Kosovës.

Edhe ministrja në detyrë e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka reaguar për vdekjen e Zejnullahut në duar të pesë policëve të Kosovës, duke thënë ka thënë se po pritet raporti final i autopsisë.

Pushojnë hetimet për ish-sekretarin e Ministrisë së Ambientit, Arben Çitaku dhe për 16 të tjerë

FERIZAJ, 8 KORRIK - Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda - ka vendosur t'i pushojë hetimet ndaj një grupi të madh të dyshuarish, përfshirë zyrtarë publikë dhe persona të tjerë.

Hetimet kanë pushuar ndaj Arben Çitakut, ish-sekretar i Ministrisë së Ambientit dhe 16 personave të tjerë.

Hetimet kanë pushuar edhe për Lubijsha Stojkoviqin, Abedin Salihun, Halim Maliqin, Sadri Lumën, Igor Joçinaqin, Abdullah

Pirçen, Blerim Imerin, Naim Alidemën, Labinot Vitijën, Nazmi Maxherën, Muhamet Malsiun, Liridon Domanekun, Milosav Grabiqin, Arton Retkocerin, Ramiz Kamerin dhe Dalibor Divkoviqin.

Të gjithë këta persona ishin nën hetim që nga viti 2022 për një sërë veprash penale që lidhen me korrupsionin, keqpërdorimin e pozitës zyrtare, ryshfetet dhe ushtrimin e ndikimit.

Hetimet kishin për qëllim zbardhjen e veprimtarisë së

pretenduar penale për: Marrje ose dhënie ryshfeti, Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, Ushtrim ndikimi, Falsifikim i dokumenteve zyrtare, Mbajtje e paautorizuar e armëve. Pas shqyrtimit të provave dhe rrethanave të rastit, prokuroria ka vlerësuar se nuk ka bazë të mjaftueshme ligjore për ta vazhduar ndjekjen penale dhe ka pushuar zyrtarisht procedurat hetimore ndaj të gjithë të përfshirëve.



KONTRATA MILIONËSHE NGA SERBIA PËR KOMPANINË E PËRFSHIRË NË AKTAKUZËN PËR BANJSKËN

PRISHTINË, 8 KORRIK - Kompania “Rad 028” nga Zveçani, në pronësi të biznesmenit nga veriu i Kosovës, Radulle Steviq, i akuzuar për përfshirje në sulmin e armatosur në Banjskë, është angazhuar në punë me vlerë mbi 3.4 miliardë dinarë, apo rreth 30 milionë euro. Këto punë financohen nga buxheti i Serbisë dhe kontratat janë nënshkruar pas sulmit në Banjskë, më 24 shtator 2023, sipas të dhënave publike të disponueshme në Portalin e Prokurimit Publik. Bëhet fjalë për 65 tenderë që i janë dhënë kompanisë “Rad 028” nga organet e përkohshme komunale serbe në Kosovë. Ato punë lidhen kryesisht me projekte infrastrukturore dhe të tjera në vendbanimet me shumicë serbe në Kosovë.

Organet e përkohshme komunale kanë funksionuar në Kosovë deri në vitin 2024, kur autoritetet e Kosovës i mbyllën me arsyetimin se ishin të paligjshme. Megjithatë, ato kanë vazhduar punën nga lokacione alternative në qytetet kufitare në Serbi. Radulle Steviq kërkohet në Kosovë nën akuzën për “financim të terrorizmit” në rastin Banjska.

Në aktakuzën e ngritur kundër 45 individëve në shtator të vitit 2024 është thënë se Steviq, me vetëdije, përmes subjekteve të tij afariste dhe aktiviteteve ekonomike, e ka ndihmuar Millan Radoçiqin, i cili ka marrë përgjegjësinë për sulmin e armatosur në Banjskë dhe ka marrë pjesë në pastrim parash, duke transferuar pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme te palë të treta, me qëllim fshehjen e origjinës së pasurisë.

Vepra penale “pastrim i parave”, për të cilën akuzohet Steviq, sipas Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit në Kosovë, dënohet me deri në dhjetë vjet burgim.

Steviq ka edhe dy kompani të regjistruara në Kosovë - “RAD D.O.O.” dhe “RAD P.T.P.” - porse nga viti 2021 nuk ka marrë më punë ose kontrata, sepse bashkë me Radoçiqin janë vendosur nën sanksione nga ShBA-ja për përfshirje në krim ndërkombëtar dhe korrupsion.

Nën këto sanksione është edhe kompania e tij e regjistruar në Serbi, “Rad 028”, por kjo nuk e pengon që të përfitojë kontrata të mëdha, të financuara nga buxheti i Serbisë, ku në shumicën e tenderëve është ofertuesja e vetme.

“Kontrata prej miliona eurosh”

Dy ditë pas sulmit në Banjskë, kompania “Rad 028” ka fituar një tender publik në vlerë prej 358 milionë dinarësh, mbi 3 milionë euro, të ndarë nga organi i përkohshëm komunal në Zveçan. Blerja kishite të bënte me pajisje ndërtimi - makina, vegla dhe mekanizma ndërtimorë - të cilat,

përmes një programi të shpërndarjes për zhvillim ekonomik dhe social për vitin 2023, do të duhej t’u shpërndahehin kompanive dhe bizneseve të tjera nga zonat me shumicë serbe në Kosovë. Vetë dokumentacioni në portalin serb të prokurimit publik e përcakton qartë se cilat kompani duhet t’i marrin pajisjet që u janë ndarë përmes këtij lloji të mbështetjes. Pajisjet dhe makineritë thuhet se janë të destinuara për popullsinë serbe që jeton në rreth dhjetë mjedise në Kosovë - përfshirë Leposaviqin, Prizrenin, Mitrovicën e Kosovës, Zveçanin dhe Zubin Potokun.

Në dokumentacion përmenden dhjetëra kompani serbe, por edhe individë, për të cilët është thënë se janë të destinuara këto pajisje.

“Radio Evropa e Lirë” nuk ka arritur ta konfirmojë nëse këto pajisje u janë dorëzuar realisht të gjithëve që figurojnë në listë, dhe as se kur ka ndodhur një gjë e tillë. Në dokumente përmenden disa kompani që, sipas aktakuzës së Kosovës, janë të lidhura me kompaninë e akuzuar “Rad 028” dhe me Radulle Steviqin.

Kështu, për shembull, mund të shihet se kompania “SEVER KOP D.O.O.” nga Leposaviqi ka përfutur një ekskavator, ndërsa dyqani tregtar i pavarur “Santos”, në pronësi të sipërmarrësit Dragan Nedelkoviq, ka marrë një pirunngritës.

Këto subjekte biznesi përmenden në aktakuzën për rastin e Banjskës në kontekstin e “raportimit fiktiv të blerjes së pajisjeve që, në shumicën e rasteve, i kishin, ndërsa paratë i mbanin për vete”. Në aktakuzë është thënë, gjithashtu, se sipërmarrësi Dragan Nedelkoviq është babai i njërit prej sulmuesve të vrarë në Banjskë, Stefan Nedelkoviq.

Në të njëjtën periudhë, pak ditë pas sulmit në Banjskë, kompania “Rad 028” nga Zveçani mori pjesë edhe në blerjen e makinave dhe pajisjeve bujqësore, përmes një programi që ndante fonde stimuluese për zhvillimin e bujqësisë në Kosovë, gjatë vitit 2023. Kjo, sipas informacioneve në portalin e prokurimeve publike të Serbisë.

Në këtë mënyrë, përmes kompanisë “Rad 028” nga Zveçani janë blerë makina bujqësore me vlerë mbi 142 milionë dinarë, ose më shumë se 1.2 milion euro. Dokumentacioni që lidhet me këtë prokurim, përmend edhe Danijell Gjukiqin, të cilit është thënë se i janë dhënë pajisje për distilieri. Gjukiq në Kosovë akuzohet si anëtar i grupit të armatosur që kreu sulmin në Banjskë.

Një person me emrin Marija Jakshiq, e cila identifikohet në aktakuzë si gruaja e Bojan Jakshiqit - i cili dyshohet se ishte përgjegjës për sigurinë e Millan Radoçiqit - përmendet në dokumentacionin e prokurimit si përdoruese e fuçive dhe pompave për dekantimin e verës, ndërsa kompania “MDJ Konstrukt”, të cilën Prokuroria e



Kosovës e lidh me Igor Millenkoviqin e vrarë në Banjskë, ka përfutur kuti për ruajtjen e frutave.

E njëjta kompani mori tenderin dhe pajisjet nga i njëjti program mbështetës

Pas shtatorit të vitit 2023, organi i përkohshëm komunal në Zveçan i ka dhënë kompanisë “Rad 028” edhe katër kontrata të tjera për furnizim me mallra, makineri dhe pajisje të ndryshme, të destinuara për nxitjen e zhvillimit ekonomik në zonat me shumicë serbe në Kosovë.

Në tri nga katër prokurimet e lartpërmendura, kompania “Rad 028” nga Zveçani mori pjesë së bashku me kompaninë “NV 028 D.O.O. Kosovska Mitrovica”, e cila përmendet edhe në aktakuzën në rastin Banjska.

Kjo kompani është themeluar më 3 prill të vitit 2024, me një mijë dinarë kapital themelues, ndërsa pronar dhe drejtor i saj është Nemanja Vujadinoviq nga Mitrovica e Veriut, tregojnë të dhënat e Agjencisë serbe të Regjistrave të Biznesit, të cilat janë të disponueshme publikisht.

Një muaj pas themelimit të saj, kompania ka fituar tenderin e parë me vlerë më shumë se 1.7 milion euro, së bashku me kompaninë “Rad 028”.

Sipas të dhënave nga portali i prokurimit publik, tenderi përfshinte prokurimin e mallrave në kuadër të një programi të stimulimit ekonomik.

Kështu, përmes programeve të ndryshme nxitëse në tre vjetët e fundit, prokurimi i mallrave me vlerë më shumë se 8.5 milionë euro i është besuar kompanisë “Rad 028” nga Zveçani dhe më vonë asaj “NV 028” nga Mitrovica e Veriut.

Në një tender të dhënë në tetor të vitit të kaluar, kompania “NV 028”, së bashku me “Rad 028” kanë fituar kontratën për një program mbështetës për ekonominë dhe zhvillimin në zonat me shumicë serbe në Kosovë. E, në dokumentacionin e prokurimit, “NV 028” figuron si përfutuese e një eskavatori.

Kontrata për furnizim në kuadër të mbështetjes për ekonominë dhe zhvillimin ekonomik në mjediset serbe në Kosovë, u është dhënë kompanive që lidhen me sulmin në Banjskë.

Kontrata për furnizim në kuadër të mbështetjes për ekonominë dhe zhvillimin ekonomik në mjediset serbe në Kosovë, u është dhënë kompanive që lidhen me sulmin në Banjskë.

Në dokumentacionin e prokurimit për stimulimin ekonomik në vitin 2024 vihet re se një makineri ndërtimore iu dha edhe kompanisë “TIME GR 028” - një tjetër subjekt që përmendet në aktakuzën në rastin Banjska.

Disa kompani që përmenden në këtë aktakuzë, kanë fituar edhe kontrata individuale, të financuara nga buxheti i Republikës së Serbisë, tregojnë të dhënat e publikuara në portalin e prokurimeve publike në Serbi.

Për shembull, “I&M STILL D.O.O.”, në pronësi të Irena Steviqit, e cila në aktakuzë është thënë se është vajza e Radulle Steviqit - pronarit të kompanisë “Rad 028” - është e angazhuar në disa punë fitimprurëse.

Pjesëmarrjen në tenderë e ka nisur që nga tetori i vitit 2020 dhe deri më 15 janar, 2025, ku ka bërë disa kontrata me organet komunale të përkohshme në Kosovë, me një vlerë të përgjithshme mbi 807 milionë dinarë, ose rreth 6.8 milionë euro.

Kompania “TIME GR 028”, e cila përmendet në aktakuzën për Banjskën, ka bërë blerje me vlerë prej më shumë se 598 milionë dinarësh, ose 5.1 milionë euro, midis 21 majit 2021 dhe 5 majit 2025.

Në anën tjetër, kompania “Santos” ka furnizuar Institucionin Parashkollor “Lane” me ushqim dhe pije, në vlerë prej rreth 90 mijë eurosh, gjatë periudhës tetor 2021 - shkurt 2025.

Punët e tjera të kompanisë “Rad 028” nga Zveçani

Përveç furnizimeve me makineri dhe pajisje për komunitetin serb në Kosovë, kompania “Rad 028” merret edhe me projekte ndërtimore.

Ndër projektet më të rëndësishme të saj është zgjerimi dhe ndërtimi i objekteve të reja të Qendrës Klinike Spitalore në Mitrovicën e Veriut, e cila funksionon brenda sistemit shëndetësor të Serbisë.

Sipas të dhënave nga portali i prokurimeve publike, vlera e kontratës kalon 3.9 milionë euro dhe është nënshkruar në fillim të

vitit 2024.

Gjatë shtatorit 2024, kompania “Rad 028” nga Zveçani së bashku me atë “Beta Gradnja” nga Mitrovica e Veriut - që po ashtu përmendet në aktakuzën për rastin Banjska janë angazhuar në blerjen e materialeve për ndërtimin, rikonstruktimin, sanimin dhe adaptimin e banesave familjare në njëzet komuna të Kosovës. Ky projekt ka një vlerë mbi 3.4 milionë euro.

Në listën e blerjeve më të fundit, më 30 qershor 2025, duket se organi i përkohshëm komunal në Zveçan i dha kontratë firmës “Rad 028” edhe për ndërtimin e një etno-fshati pranë manastirit Draganac, që gjendet afër Novobërdës, në jug të Ibrit. Vlera e këtij projekti është mbi 1.2 milion euro.

A mund të ndërtojë kompania “Rad 028” në Kosovë?

Në tre vjetët e fundit, autoritetet e Kosovës i kanë ndaluar ndërtimet në zonat me shumicë serbe, të financuara nga Serbia, duke argumentuar se ato nuk kanë leje nga institucionet e Kosovës, por vetëm leje të lëshuara nga organet serbe, të cilat Prishtina zyrtare nuk i njeh. Në mesin e të tjerave është bllokuar ndërtimi i ndërtesave të universitetit paralel, punimet e të cilave po i kryente firma “Rad 028” e Steviqit.

“Radio Evropa e Lirë” ka kontaktuar Qeverinë e Kosovës, Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve dhe autoritetin e tenderëve për t’i pyetur nëse kanë informacione se Radulle Steviq, me kompaninë e tij nga Serbia ose me ato të regjistruara në Kosovë, po realizon projekte të financuara nga buxheti i Serbisë, por, deri në publikimin e këtij artikulli, nuk ka marrë përgjigje prej asnjërit institucion.

Më herët, nga autoriteti i tenderëve i kanë thënë “REL”-it se kompanitë e Steviqit në Kosovë nuk janë në listën e zezë, sepse nuk ka pasur ankesa nga klientët, e as nuk është vërtetuar se ai ka dorëzuar të dhëna të reme ose dokumente të falsifikuara.

Ligji për prokurimet publike në Kosovë parashikon masa për vendosjen në listë të zezë vetëm kur porositësi i punës thotë se janë paraqitur të dhëna të reme ose dokumente të falsifikuara.

Bazuar në të dhënat e publikuara në portalin e Kosovës “Prokurimi i Hapur”, ku mund të gjenden informacione për kontratat publike në Kosovë që nga viti 2018, kompanitë e Steviqit kanë marrë rreth 5 milionë euro nga buxheti i Kosovës deri në vitin 2021.

Shërbimet e kompanisë së tij u përdorën kryesisht nga komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës, që veprojnë sipas sistemit të Kosovës - Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok.

DEMI: KOSOVA SHPENZOI 574 MILIONË EURO PËR RRYMË, NDIHMA SHKOI KRYESISHT PËR MË TË PASURIT

PRISHTINË, 8 KORRIK - Kosova ka shpenzuar mbi 6 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) për ta mbajtur këtë çmim të ulët, sipas të dhënave të publikuara nga Atlas Institute dhe OECD (2025). Megjithatë, analiza ka treguar se pjesa më e madhe e kësaj ndihme nuk përfitohet nga familjet e varfra, por nga ato që nuk kanë nevojë për të.

“Kur thonë rryma tek ne është e lirë, dijeni që çmimin real të rrymës janë duke e paguar shtresat më të varfra. Në krahasim me vendet e rajonit, Kosova shpenzon shuma të mëdha të parave për subvencionim direkt dhe indirekt të rrymës. E mbi 90 për qind e këtij subvencionimi shkon tek ato kategori të qytetarëve dhe bizneseve që nuk kanë nevojë për subvencionim. Vetëm 9 për qind të subvencionimit shkon tek familjet më të varfra.”, ka thënë Agron Demit nga Atlas Institute.

Të dhënat kryesore (2018-2023) kanë treguar se Kosova ka

shpenzuar gjithsej 2.2 miliardë euro për subvencionimin e tarifave të energjisë përmes çmimeve të ulëta.

Mbështetja fiskale dhe kreditore ka arritur në 608 milionë euro, prej tyre: 574 milionë euro mbështetje fiskale dhe 33 milionë euro mbështetje kreditore.

Sipas Atlas Institute, vetëm 9.2 për qind e subvencionimit të fshehur përfitohet nga familjet më të varfra. Pjesa dërrmuese (mbi 90 për qind) përfitohet nga familjet më të pasura dhe bizneset, për shkak se tarifafat ishin të njëjta për të gjithë.

Raporti ka nënvizuar se kjo qasje e subvencionimit të përgjithshëm, në vend të ndihmës së synuar për kategoritë në nevojë, thëllon pabarazitë sociale dhe financiare. Në vend që të ndihmohen ata që realisht nuk mund të përballojnë faturat e energjisë, politika e tarifave të rregulluara i ka përfshirë të gjithë, duke përfutur më së shumti ata që mund të paguanin vetë.



ASK-ja: MBI 207 MIJË BANESA TË BLERA, POR TË PABANUARA NË KOSOVË



PRISHTINË, 8 KORRIK - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar raportin me të dhëna për banesat dhe ndërtesat sipas komunave në kuadër të Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave 2024. Ky publikim ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse mbi strukturën e banesave në nivel kombëtar dhe komunal, duke përfshirë tregues të rëndësishëm që ndihmojnë në analizimin e zhvillimeve në sektorin e banimit dhe planifikimin urban.

Sipas të dhënave të publikuara, në Kosovë janë regjistruar gjithsej 581 mijë e 95 banesa, nga të cilat 356 mijë 959 janë të banuara nga një ose më shumë banorë. Ndërkohë, 207 165 banesa, që përbëjnë 35.7 për qind të totalit, rezultojnë të pabanuara, përfshirë ato të destinuara për shitje, dhënie me qira apo përdorime të tjera.

Raporti përshin informacione

për: numrin e përgjithshëm të banesave sipas komunave, shpërndarjen e banesave në vendbanime urbane dhe rurale, klasifikimin e banesave në të banuara dhe të pabanuara, llojin e furnizimit me ujë, llojin e sistemit të shkarkimit të ujërave të zeza, mënyrat e ngrohjes në banesa dhe numrin e dhomave në banesat e zakonshme.

ASK-ja ka theksuar se këto të dhëna janë një burim i rëndësishëm për politikën zhvillimore si dhe për hartimin e strategjive për përmirësimin e kushteve të banimit dhe menaxhimit e qëndrueshëm të hapësirës.

Analiza e shpërndarjes së banesave të banuara dhe të pabanuara shërben për t'i kuptuar trendet e zhvillimit urban dhe rural, duke ndihmuar komunat në planifikimin e nevojave të ardhshme për infrastrukturë dhe shërbime publike.

Peci: Kosova thyen rekord në mbjelljen e grurit, mbi 74 mijë hektarë të mbjella në vitin 2025

SUHAREKË, 8 KORRIK - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti dhe ministri në detyrë i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, kanë ndjekur të martën nga afër ecurinë e korrje-shirjeve në fshatin Sopijë të Suharekës. Me këtë rast, Peci ka njoftuar se Kosova ka arritur një rekord të ri në sektorin e bujqësisë, me mbi 74 mijë hektarë të mbjella me grurë në nivel vendi për vitin.

“Vitin e kaluar shënuam rekord të të mbjellave dhe rendimentit dhe siguruam bukën e motmotit. Këtë vit kemi thyer rekord të ri. Janë mbi 21 mijë hektarë më shumë të mbjella me grurë sesa në vitin paraprak”, ka thënë Peci.

Më tutje, Peci ka theksuar rëndësinë ekonomike të kësaj arritjeje. “Marrë në tërësi me një mesatare minimale, Kosova minimalisht ka prodhuar këtë

vit mbi 56 milionë euro në vlerë të sasisë së grurit, dhe mbi 74 mijë hektarë në nivel vendi që është rekord i ri në sektorin e bujqësisë”, ka thënë Peci.

Fushata e korrje-shirjeve do të vazhdojë në ditët e ardhshme në gjithë Kosovën, me qëllim të mbledhjes së prodhimit maksimal dhe sigurimin e një viti të frytshëm për fermerët dhe konsumatorët.



KABULI MUND TË BËHET KRYEQYTETI I PARË NË BOTË PA UJË, ÇFARË THONË EKSPERTËT

Kabuli mund të bëhet kryeqyteti i parë në botë që do të mbetet plotësisht pa ujë, kanë thënë ekspertët, të cilët duke folur për krizën kanë përmendur disa faktorë që kanë përkeqësuar situatën, përfshirë rritjen e shpejtë të popullsisë, ndryshimet klimatike dhe keqmenaxhimin. Nivelet e ujërave nëntokësore të kryeqytetit afgan kanë rënë gati 30 metra gjatë dekadës së fundit, ndërsa pothuajse gjysma e puseve të qytetit – burimi kryesor i ujit të pijshëm për banorët – tashmë janë të thara, sipas një studimi të kryer së fundmi nga organizata joqeveritare, Mercy Crops. Kërkesa për ujëra nëntokësore në qytet është në mënyrë disproporcionale e lartë: çdo vit, nxirren 44 milionë metra kub më shumë ujë sesa mund të sigurohet rimbushja. Popullsia e Kabulit është rritur prej gati 2 milionë në vitin 2000, në më shumë se 6 milionë banorë më 2025, duke rritur stërngarkuar furnizimet me ujë, të cilat mund të shterojnë brenda pesë vjetësh. Edhe sasitë e ujit nëpër thellësi të tokës kanë nisur të thahen për shkak të mbi 100.000 puseve të parregulluara dhe qindra fabrikave dhe serrave, sipas ekspertëve të organizatës Mercy Corps dhe ekspertëve për menaxhim të ujit, me të cilët ka biseduar Radio Evropa e Lirë.

“Kabuli i ka më shumë se 400 hektarë me serra që harxhojnë rreth 4 milionë metra kub të ujit brenda vitit”, ka thënë Najibullah Sadid, hulumtues për burime të ujit dhe ndryshime klimatike, me seli në Gjermani. “Ekzistojnë më shumë se 500 biznese pijesh që operojnë në Kabul. Prej tyre, Alokozay, kompania më e madhe e lëngjeve në qytet, përdor rreth 1 milion metra kub të ujërave nëntokësore çdo vit”. Kombet e Bashkuara kanë paralajmëruar se pa vepruar shpejt, ujërat nëntokësore të Kabulit mund të shterohen plotësisht deri më 2030, çka përbën kërcënim ekzistencial për banorët dhe rrezikon valë të madhe migrimi.

‘Të zgjedhësh në mes të ujit dhe ushqimit’

Shumë zona të Kabulit tashmë janë tharë dhe banorët varen krejtësisht nga sasia e kufizuar e ujit që blejnë nga cisternat. Një person që jeton në zonën relativisht të pasur, Taumani, në veriperëndim të Kabulit, ka thënë se shpenzon një çerek të pagës së tij për blerje të ujit. “Paga ime mujore është 300 dollarë dhe unë i shpenzoj 70 dollarë në ujë për familjen tonë



prej 10 anëtarësh”, ka thënë ai për Radion Evropa e Lirë më 26 korrik. “E përdorim këtë ujë për çaj, gatime, pastrim të rrobave dhe higjienë”. “Ka shumë familje që nuk e përballojnë blerjen e ujit dhe është sikur të zgjedhësh në mes të ujit dhe ushqimit”, ka thënë ky banor i Taimanit. Ai ka thënë se ata që nuk e përballojnë financiarisht blerjen e ujit, udhëtojnë dhjetëra kilometra për ta siguruar atë prej zonave tjera. Shumë blloqe apartamentesh në Kabul kanë ujë vetëm një apo dy herë në javë. Ndotja e ujit është një tjetër sfidë që ka prekur Afganistanin, ku 80 për qind e popullsisë nuk ka qasje në ujë të sigurt për pirje, sipas të dhënave të Kombeve të Bashkuara. Një sasi e madhe e ujërave nëntokësore në Kabul është e kontaminuar me ujëra të zeza, toksina dhe nivele të larta të arsenikut.

Zgjidhjet potenciale

Sipas Bankës Botërore, Qeveria e mëparshme e Afganistanit, e përkrahur nga Perëndimi – e cila është rrëzuar më 2021 – i ka pranuar më shumë se 4 miliardë dollarë nga donatorët ndërkombëtarë për të

reformuar sektorin e ujit, mirëpo ai vazhdon të jetë i pazhvilluar si në kryeqytet, ashtu edhe në pjesën tjetër të vendit. Zyrtarët e Qeverisë aktuale në Kabul – që drejtohet nga talibanët – nuk i janë përgjigjur kërkesës së Radios Evropa e Lirë për koment. Megjithatë, shumë ekspertë lokalë besojnë se kryeqyteti afgan ka ende mundësi që të zgjidhë krizën me ujë relativisht shpejt, nëse merren hapa vendimtarë. “Ky problem nuk është i ri. Për më shumë se një dekadë janë prezantuar ide para autoriteteve afgane se si mund të zgjidhet ky problem, por ai nuk ka qenë asnjëherë prioritet”, ka thënë Sadid për Radion Evropa e Lirë. Në mesin e ideve ka qenë edhe ndërtimi i digës Shahtoot dhe një rezervuari, rreth 30 kilometra në jugperëndim të Kabulit. Nëse do të përfundohej, sistemi do të mund t’i furnizonte më shumë se 2 milionë banorë të qytetit me ujë dhe do t’i shmangte problemet anësore. Një tjetër projekt parasheh ndërtimin e një tubacioni prej 200 kilometrash për të devijuar më shumë se 100 milionë metra kub të ujit brenda vitit nga lumi Panjshir, që kalon nëpër kryeqytet.

Qeveria paraprake i ka kryer edhe studimet e fizibilitetit për të dyja këto projekte. Në prill, Ministria e talibanëve për Energji dhe Ujë, ka thënë se është në pritje të miratimit të buxhetit për të nisur punën për ndërtimin e tubacionit në lumin Panjshir. Ka raportime se autoritetet janë në kërkim të investitorëve për këtë iniciativë që besohet se kushton 170 milionë dollarë. Ndërkohë, projekti Shahtoot pritet të përfundohet më 2027, nëse Afganistani arrin t’i sigurojë fondet. Vlerësohet se i gjithë projekti do të kushtojë rreth 236 milionë dollarë për të kompletuar digën dhe rezervuarin. Abdul Baset Rahmani, ekspert për burime të ujit dhe ndryshime klimatike, me seli në Kabul, ka thënë se mungesa e ujit në kryeqytetin afgan “mund të zgjidhet brenda një viti e gjysmë, nëse ka vullnet politik”. Megjithatë, ai ka paralajmëruar për nevoja urgjente në periudhë afatshkurtër, duke u bërë thirrje agjencive ndërkombëtare të ndihmës “të ofrojnë ndihmë urgjente për personat e varfër në Kabul, të cilët nuk mund ta përballojnë blerjen e ujit të pijshëm”. “Një mbështetje e tillë do t’i

lehtësonte shumë njerëz nga vështirësitë e mëdha financiare dhe mendore, do t’i parandalonte sëmundjet dhe do të ndihmonte në kthimin e shumë njerëzve në shkollë”, ka thënë ai. “Janë shumë fëmijë që nuk mund të kenë qasje në edukim sepse duhet të ecin me kilometra për t’iu ndihmuar familjeve për t’u furnizuar në zonat ku ka ujë të pijshëm falas”. Grupet e ndihmës, sikurse Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq dhe Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Fëmijë (UNICEF), kanë realizuar disa projekte në Afganistan në vjetët e fundit për t’iu ndihmuar mijëra personave që të kenë qasje në ujë të pijshëm. Sipas Kryqit të Kuq, në projektet e tyre më 2024 përfshihet riparimi i “1.315 pompave të dorës dhe instalimi i 1.888 filterëve të rërës për t’i larguar ndotësit nga uji”, në disa provinca afgane. Pavarësisht këtyre përpjekjeve, përveç nëse Qeveria ndërmerr hapa urgjentë, apo përfundohen projekte të mëdha infrastrukturore, kriza e Kabulit me ujë pritet të vazhdojë dhe mund t’i detyrojë rreth tre milionë banorë – apo gjysmën e popullsisë së Kabulit – që të largohen nga qyteti./ REL



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Presidenti i KOK-ut priti drejtuesit e Federatës së Volejbollit të Malit të Zi

PRISHTINË, 8 KORRIK - Presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Ismet Krasniqi, të martën ka pritur në takim drejtuesit e Federatës së Volejbollit të Malit të Zi, kryetarin Nikola Kazhiq dhe sekretarin e përgjithshëm Ivan Boshkoviq. Në takim morën pjesë edhe krerët e Federatës së Volejbollit të

Kosovës, kryetari Bahri Gjinovci, njëherësh anëtar i Bordit Ekzekutiv të KOK-ut dhe sekretarin e përgjithshëm, Valon Nikqi. Drejtuesit e Federatës së Volejbollit të Malit të Zi po qëndrojnë në Kosovë me rastin e zhvillimit të CEV Kampionatit Evropian U16 për vajza, i cili po

mbahet paralelisht në Prishtinë dhe Tiranë, për të cilin Kosova është një nga organizatorët kryesore. Kazhiq është edhe anëtar i Bordit Ekzekutiv të Komitetit Olimpik të Malit të Zi. “Gjatë takimit presidenti Krasniqi shprehu falënderimin e tij për vizitën dhe theksoi rëndësinë që ka

bashkëpunimi ndërmjet federatave të rajonit për zhvillimin e sportit në përgjithësi dhe volejbollit në veçanti. Ai vlerësoi pjesëmarrjen dhe angazhimin e FVMZ-së në këtë ngjarje të madhe evropiane dhe u shpreh i gatshëm për thellimin e bashkëpunimit ndërins-titucional”, thuhet në njoftimin e KOK-ut.



DREJTORIA E SPORTIT NË PRISHTINË, PAS BLLOKIMIT TË BUXHETIT: E PAMUNDUR MBËSHTETJA FINANCIARE PËR SPORTISTËT

“Epoka e re”

PRISHTINË, 8 KORRIK - Drejtoria e Sportit e komunës së Prishtinës ka njoftuar sportistët, trajnerët, klubet dhe qytetarët e kryeqytetit, se është bllokuar buxheti i komunës së Prishtinës nga niveli qendror. Drejtoria e Sportit bëri me dije se ka përfunduar me kohë dhe në mënyrë të rregullt të gjitha procedurat ligjore dhe administrative për hapjen e thirrjes publike për subvencionimin e sportistëve dhe klubeve sportive të kryeqytetit, një proces që është ndjekur çdo vit me seriozitet të lartë institucional, por bllokimi i

buxhetit nuk lejon të mbështeten sportistët që përfaqësojnë me dinjitet dhe krenari kryeqytetin brenda dhe jashtë vendit. “Përkundër angazhimit dhe përgatitjes sonë të plotë, fatkeqësisht këtë vit e kemi të pamundur të procedojmë me përkrahjen financiare për sportistët tanë për shkak të bllokimit të buxhetit të komunës së Prishtinës nga niveli qendror. Kjo situatë ka ndikuar drejtpërdrejt në pamundësinë për ta ofruar mbështetjen financiare për sportistët që përfaqësojnë me dinjitet dhe krenari kryeqytetin tonë brenda dhe jashtë vendit. Sportistët tanë nuk meritojnë të jenë viktimë të kalkulimeve politike, të cilat në



vend se t'i forcojnë institucionet lokale dhe ta mbështesin talentin vendor, po u pamundësojnë atyre ushtrimin e një të drejte themelore

- përkrahjen institucionale që u takon me meritë”, thuhet në njoftimin e kësaj drejtorie. Drejtoria e Sportit ka shprehur

keqardhje dhe i ka siguruar sportistët se mbetet e përkushtuar që, përkundër sfidave, ta vazhdojë angazhimin e pandërprerë në mbrojtje të të drejtave të komunitetit sportiv të kryeqytetit dhe në mbështetje të zhvillimit të mëtejshëm të sportit, si një prej shtyllave themelore të jetës sonë shoqërore dhe kulturore. “Shpresojmë fuqishëm që kjo situatë do të gjejë zgjidhje sa më parë dhe që do të na mundësohet rikthimi në funksionimin e rregullt institucional, për të vazhduar mbështetjen meritore për të gjithë ju që po e nderoni emrin e Prishtinës me përkushtim, sukses dhe profesionalizëm”, thuhet në njoftimin e Drejtorisë së Sportit në Prishtinë.

SOT FILLON EVROPIANI I ESPORTS NË KOSOVË, SERBIA NUK MERR PJESË

PRISHTINË, 8 KORRIK - Nga 9 deri më 13 korrik në palestërën “1 Tetori” në Prishtinë do të mbahet edicioni i radhës i Kampionatit Evropian të Esports, një prej ngjarjeve më të mëdha në sportet elektronike në kontinent. 36 ekipe nga 25 shtete të Evropës do të marrin pjesë në këtë kampionat dhe do të garojnë në tri disiplina: CS2, CS2 Women dhe Dota2. Kosova jo vetëm që do të jetë mikpritëse e kësaj gare madhore, por edhe do të përfaqësohet me ekipin e saj kombëtar në të tri kategoritë. Zëvendësministria në detyrë e Ministrisë së Sportit, Daulina Osmani, theksoi se organizimi i kësaj ngjarje është dëshmi e përkushtimit ndaj të rinjve për t'ua dhënë atyre rastin që të dëshmojnë para botës edhe në lojëra elektronike, gjithashtu edhe hap dyert për të rinjtë e botës që të



vijnë në Kosovë. “Për Kosovën kampionati është shumë më shumë se një garë sportive, është dëshmi konkrete e vizionit tonë për ta bërë Kosovën qendër të inovacionit dhe sportit... Këtë organizim e kemi mbështetur së bashku me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ku përmes ngjarjeve si kjo po investojmë në prezantim të kapacitetit të të rinjve tanë që i kemi në arenën ndërkombëtare, njëkohësisht po i hapim dyert e shtetit tonë për të rinjtë nga Evropa dhe po ua

hapim mundësinë që të vijnë e ta shohin një Kosovë dinamike dhe inovative”, ka thënë Osmani. Ajo gjithashtu bëri me dije se në këtë kampionat evropian nuk do të marrë pjesë Serbia e cila është tërhequr në çastet e fundit dhe, sipas Osmanit, Kosova kishte përgatitur ambient të përshtatshëm dhe të barabartë për të gjithë. Sipas Osmanit, sportistët nga Serbia ishin të gatshëm të vinin në Kosovë, por vendimi për mospjesëmarrje ishte krejtësisht politik. “Nga 25

shtete të konfirmuara paraprakisht për pjesëmarrje në këtë kampionat, sot realisht i kemi vetëm 24 shtete për shkak të tërheqjes të reprezentacionit të Serbisë nga pjesëmarrja në kampionat në momentet e fundit... Republika e Kosovës ka garantuar mjedis të barabartë dhe të sigurt për të gjitha shtetet dhe për të gjithë sportistët. Nga perspektiva e sportistit është për të ardhur keq që institucionet shtetërore të Serbisë nuk i lejojnë sportistët e tyre të vijnë dhe të marrin pjesë në garën më të madhe të Esports. Edhe pse vetë sportistët kanë qenë të gatshëm të vijën të garojnë, janë pikërisht vet institucionet e tyre ato të cilat edhe i penguan që të jenë pjesëmarrës. Pra ky nuk ka qenë vendim sportiv, është e kundërta, ka qenë vendim tipik politik i politikave shtetërore të Serbisë”, ka shtuar Osmani.

Sekretari përgjithshëm i Federatës Ndërkombëtare të Esports (IESF), Boban Totovski, ka thënë se vendimi i Serbisë është çështje e brendshme e tyre dhe se ata nuk e detyrojnë askënd me forcë të marrë pjesë në gara. “Shoqata e Sportit e Serbisë ka vendosur të tërheqë atletët e regjistruar dhe të kualifikuar dhe të mos marrin pjesë në këtë event, për arsye të brendshme ata nuk treguan më tej. Ne sigurisht nuk mund t'i kërkojmë me forcë askujt të marrë pjesë, ne po mundohemi të ndajmë esportin nga politika por për fat të keq në kohën të cilën jetojmë, jo vetëm luftërat por edhe konfliktet politike që po ndodhin, po bëhet shumë e më shumë e komplikuar të bëjmë këtë ndarje në evente specifike”. Ky kampionat organizohet nga Federata Esports Kosova me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

KB Bora transferon Rron Ukajn

PRISHTINË, 8 KORRIK - Pas zyrtarizimit të trajnerit Lubomir Minchev, KB Bora ka bërë transferimin e parë për sezonin 2025/26. Rron Ukaj është përforcimi i parë i skuadrës nga

kryeqyteti, që në sezonin e ri të Superligës së Kosovës në basketboll do të futet me ambicie të mëdha. Ukaj, që luan në pozitën e krah-qendrës, sezonin e shkuar ishte

pjesë e skuadrës së Pejës, ku luajti me një mesatare prej 5 pikëve e 4 kërcimeve për ndeshje. Skuadra e Borës sezonin e fundit debutoi në elitën e basketbollit të Kosovës dhe mbijetesën në

Superligë e siguroi nëpërmjet ndeshjes së “play-out”-it. Në sezonin e rregullt të Superligës, Bora regjistroi 9 fitore karshi 19 humbjeve në 28 ndeshje të zhvilluara.



Verstappeni dorëzohet: S'ka më rëndësi si i përfundojmë garat

MILTON KEYNES, 8 KORRIK - “Prisja një garë të vështirë, me atë mot të keq, por kështu... Nuk ka asgjë që mund të bëjmë për këtë. Sidoqoftë, nuk po luftojmë për kampionatin, kështu që nuk ka rëndësi”, u shpreh Max Verstappen, që zhgënjeu edhe në garën e Silverstones. Ëndrra e një titulli të pestë

radhazi për pilotë në Formula 1 është shumë larg, ndjesia me makinën është në nivelin më të ulët historik dhe ajo me ekipin është po aq e ulët. “Pole position” i së shtunës ishte një qetësues i padobishëm, pasi gara e së dielës ishte përfaqësimi i qartë i të gjitha vështirësive që po përjeton Red Bulli. Në

fakt, Verstappeni po kërkon një arsye për të qëndruar në Red Bull dhe për të pasur besim në ekip me synimin për vitin 2026, por gara e Silverstones veprooi në drejtim të kundërt. Gjatë fundjavës Jos Verstappen, babai i Max, u pa duke biseduar me Christian Horner, shefin e Red Bullit në

mbrëmje. Biseda midis të dyve u përcaktua nga mediet gjermane si “jomiqësore”. “Nuk dua të flas për të ardhmen”, u përgjigj kampioni në fuqi, fjalë duket se konfirmojnë se diçka po lëviz nën radar. Verstappeni nuk i ka mohuar kurrë negociatat me Wolffin dhe nuk e ka konfirmuar kurrë me



siguri praninë e tij në timon të Red Bullit në vitin 2026.

Juventusit në garë për Xhakën

TORINO, 8 KORRIK - Juventusit është në kërkim të përforsimeve për repartin e mesfushës, me objektivin për t'i dhënë trajnerit Igor Tudor një lojtar që kombinon cilësitë e një regjisorit me ato të një shkatërruesi të aksioneve kundërshtare. Sipas raportimeve të “Gazzetta dello Sport”, drejtuesit bardhezi kanë bërë sondazhe për disa emra të rëndësishëm, përfshirë Sandro Tonali, Wilfred Ndidi dhe Yves Bissouma. Mes tyre është shtuar edhe profili i Granit Xhakës, mesfushorit të përfaqësueses së Zvicrës dhe aktualisht pjesë e Bayer Leverkusenit. Xhaka më herët ka qenë në radarët e Milanit. Duket se mund të largohet këtë verë nga klubi gjerman, që tashmë drejtohet nga trajneri i ri Erik ten Hag pas largimit të Xabi Alonso. Çmimi i kërkuar për kartonin e tij është



relativisht i arritshëm, mes 12 dhe 15 milionë euro, shumë më pak se 70 milionët që do të duheshin për ta rikthyer Tonalin në Serinë A. Pavarësisht se është 32-vjeçar, Xhaka mbetet një lojtar me përvojë të madhe ndërkombëtare, duke luajtur në nivele të larta me Basel, Arsenal dhe Leverkusen, si dhe me Zvicrën në kampionate botërore dhe evropiane. Ai vetë është i prirë të provojë një përvojë

të re, pas aventurave në Premierë Ligë dhe Bundesliga. Ndërkohë, shumë do të varet edhe nga ardhmja e Douglas Luizit. Mesfushori brazilian ka zhgënjyer në sezonin e tij të parë me bardhezinjtë, por drejtuesit e klubit nuk janë të gatshëm ta shesin për një çmim të ulët. Pritet që Juventusit të shtojë të paktën dy emra të rinj në mesin e fushës për sezonin e ri.

Finalja e parakohshme Real - PSG

NJU-JORK, 8 KORRIK - Real Madrid - PSG do të jetë padyshim finalja e parakohshme e Botërorit për Klube, duke qenë se të mërkurën në New York do të vihen përballë dy skuadrat për ngritjen lart të trofeut. Nga njëra anë kampionia e Evropës, PSG, që edhe ndaj Bayernit tregoi se vijon sezonin shpërthyes me ekipin e Luis Enriques që nuk po njih rival dhe, nga ana tjetër, Realit i Xabi Alonso. Megjithatë është ende herët për ta quajtur të tillë, duke qenë se tekniku spanjoll ka shumë pak javë që është në krye të mbretërorëve, skuadra e Real Madridit mbetet gjithnjë një emër i madh i futbollit botëror, një skuadër që është në gjendje të mposhtë këdo e në çdo kohë. Por një sfidë brenda sfide do të jetë padyshim takimi me të kaluarën e tij nga sulmuesi francez Kylian Mbappe. 7 sezone te parisienët janë mjaftueshëm për t'i dhënë një peshë të fortë emocionale Mbappes teksa do ta sfidojë ish-skuadrën e tij për herë të parë. Së fundmi mësohet se Kylian Mbappe ka tërhequr padinë



penale për ngacmim moral dhe tentativë shantazhi ndaj ish-klubit të tij, PSG, të paraqitur më 16 maj. Sipas “L'Equipe”, lojtari i Real Madridit ka vendosur t'i ulë tensionet ligjore për t'u fokusuar te futbollit. Megjithatë, ai vazhdon procesin në gjykatën e punës në Francë, ku kërkon rreth 55 milionë euro nga PSG-ja për paga dhe bonuse të papaguara. Marrëdhëniet mes palëve janë tashmë dukshëm të përmirësuara. Ndërkohë Real Madridi, megjithatë ka mbërritur deri në gjysmëfinale të Botërorit për Klube, po mendon për sezonin e ardhshëm. Në veçanti, klubi i

Florentino Perezit i ka kërkuar federatës spanjolle ta shtyjë ndeshjen e tij të parë në La Liga 2025/2026 kundër Osasunës. Java e parë e kampionatit spanjoll është planifikuar për datat 16 dhe 17 gusht, me ndeshjen Real Madrid - Osasuna që ishte caktuar fillimisht për të martën më 19 gusht, pikërisht për shkak të pjesëmarrjes në Kupën e Botës për Klube. Por kjo nuk mjafton: tani “Los Blancos” ka kërkuar që ajo të shtyhet deri në tetor, në mënyrë që të ketë një javë shtesë pushimi pas lodhjeve të turneut në Amerikë. Pritet shumë shpejt të mësohet edhe se cila do të jetë përgjigjja e federatës spanjolle.

SHKURT

Beshiktashi pranon shitjen e Rashicës

Milot Rashica pritet që sezonin e ri të jetë pjesë e Bundesligës së Gjermanisë. Mediumet turke kanë raportuar të martën se Beshiktashi ka pranuar shitjen e Rashicës te Borussia Monchengladbachu, ekip që ka insistuar për shërbimet e tij. Në fakt, thuhet se Gladbachu kishte ofruar 10 milionë euro për kartonin e Rashicës, çmim i pranueshëm nga Beshiktashi, i cili veçse e kishte nxjerrë sulmuesin e krahut në një sezon të suksesshëm ku katalanasit fituan La Ligën, Copa del Rey dhe Superkupën e Spanjës. “FC Barcelona dhe lojtari Wojciech Szczesny kanë arritur një marrëveshje për rinovimin e kontratës së tij, e cila do ta lidhë lojtarin me klubin deri më 30 qershor 2027”, thuhet në njoftimin. Pritet që Szczesny ta ketë rolin e portierit të dytë sezonin e ardhshëm, duke mbështetur Joan Garcia, transferimin e ri të klubit në këtë pozicion. Ndërkohë, Marc-Andre ter Stegen pritet të largohet nga Barça.

Szczesny rinovon me Barçën deri në vitin 2027

Barcelona ka konfirmuar se portieri polak Wojciech Szczesny ka nënshkruar një kontratë të re dyvjeçare me klubin, që e mban atë në “Camp Nou” deri më 30 qershor 2027. Szczesny doli nga pensionimi sezonin e kaluar për ta ndihmuar Barcelonën dhe pati një ndikim të madh, duke kontribuar në një sezon të suksesshëm ku katalanasit fituan La Ligën, Copa del Rey dhe Superkupën e Spanjës. “FC Barcelona dhe lojtari Wojciech Szczesny kanë arritur një marrëveshje për rinovimin e kontratës së tij, e cila do ta lidhë lojtarin me klubin deri më 30 qershor 2027”, thuhet në njoftimin. Pritet që Szczesny ta ketë rolin e portierit të dytë sezonin e ardhshëm, duke mbështetur Joan Garcia, transferimin e ri të klubit në këtë pozicion. Ndërkohë, Marc-Andre ter Stegen pritet të largohet nga Barça.

Bayerni: Musiala do të mungojë disa muaj

Jamal Musiala është operuar me sukses pasi e ka thyer këmbën dhe e përndrydhur kyçin. Klubi i Bayern Munchenit ka reaguar duke bërë me dije se mesfushori me tipare sulmuese do të mungojë për disa muaj. “Jamal Musiala i është nënshtruar me sukses një ndërhyrje kirurgjikale. Ai do të nisë menjëherë fazën e rehabilitimit që këtë të martë. Jamali nuk do të jetë i disponueshëm për ekipin për disa muaj”, thuhet në njoftimin e Bayernit. Sipas medieve gjermane, Musiala pritet të mungojë afro 4-5 muaj.

Napoli nuk e pranon ofertën e Galatasarayt për Osimhenin

E ardhmja e Victor Osimhenit mbetet në pikëpyetje. Sulmuesi nigerian do të dëshironte të qëndronte në Turqi dhe Galatasaray po bën përpjekje serioze për ta mbajtur. Huazimi i tij ka përfunduar dhe lojtari është kthyer zyrtarisht te Napoli, por jo për të qëndruar. Presidenti Aurelio De Laurentiis kërkon ta shesë Osimhen për një shumë 75 milionë eurosh, e vlefshme vetëm për klubet jashtë Italisë. Napoli nuk ka ndër mend të heqë dorë nga kjo shumë, ndonëse Galatasaray ka paraqitur një ofertë prej 60 milionësh. Osimhen ka bërë me dije se dëshiron të qëndrojë te Galatasaray dhe klubi turk ka arritur një marrëveshje me lojtarin për një kontratë deri më 30 qershor 2028. Al Hilali dhe Juventusit gjithashtu janë interesuar për transferimin e Osimhenit.

Guardiola: Shpresoj që lodhja e lojtarëve të mos ndikojë në sezonin tjetër

Trajneri i Manchester Cityt, Pep Guardiola, pas eliminimit një javë më parë nga Kupa e Botës për Klube, ka kthyer menjëherë vëmendjen te sezoni i ardhshëm. Ai e di mjaft mirë se

ka pak kohë në dispozicion për të punuar, pasi Premierë Liga do të nisë në mes të gushtit. “Nuk mund t'i falënderoj mjaftueshëm lojtarët për stërvitjen dhe lojën që kanë

bërë në Kupën e Botës për Klube. Do të na pëlqente shumë të kishim vazhduar, pasi do të organizohet një herë në katër vjet, por kjo do të thotë se do të kemi pak mundësi të

pushojmë”, ka thënë Guardiola. “Është koha të pushojmë dhe t'i qetësojmë mendjet tona për sezonin e ri. Ka qenë një sezon shumë i gjatë, me mjaft probleme për ne, ndaj ky

pushim do të na bëjë mirë. Shpresoj shumë që kjo lodhje të mos ndikojë edhe në sezonin tjetër, sidomos në periudhën e dimrit”, ka deklaruar trajneri spanjoll.



KOLEGJI - COLLEGE

BIZNESI

Prishtinë

Rr"Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, Ulpianë 10000 Prishtinë – Kosovë, www.kolegjobiznesi.com,

Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878 info@kolegjobiznesi.com

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: 30.05.2025, të Kolegjit “BIZNESI” Prishtinë dhe Dega në Prizren:

Kolegji Biznesi shpall konkursin publik të rregullt për pranimin dhe regjistrimin e studentëve të rinj për vitin akademik 2025/2026, në të gjitha programet e studimit të akredituara nga Agjencia e Akreditimit e Kosovës dhe të licencuara nga MASHT.

Të drejtë aplikimi dhe regjistrimi në studimet themelore (Bachelor) e kanë të gjithë kandidatët që e kanë përfunduar shkollimin e mesëm të lartë dhe që e kanë përfunduar me sukses testin kombëtar të maturës. Kurse në studimet Master kanë të drejtë aplikimi dhe regjistrimi të gjithë kandidatët që i kanë përfunduar Studimet Bachelor.

Studime Bachelor
1.Banka dhe Financa në Biznes (Ba) - (3 Vjeçar)
2.Menaxhment dhe Ekonomiks (Ba) - (3 Vjeçar)
3.Menaxhimi i Emergjencave (Ba) - (3 Vjeçar)
4.Juridik / LLB - (4 Vjeçar)
5. Shkenca Kompjuterike Bsc - (3 Vjeçar)

Studime Master
1.Menaxhment dhe Financa – MA-(2 Vjeçar)
2.Menaxhimi i Emergjencave – MA-(2 Vjeçar)

Studentët të cilët aplikojnë në studimet Bachelor, i bashkëngjisin aplikacionit:

- Certifikata e maturës shtetërore – origjinale ose kopje e noterizuar;
- Diploma e shkollës së mesme – origjinale ose kopje e noterizuar;
- Dëftesat e shkollës së mesme – origjinale ose kopje e noterizuar;
- Ekstrakti i lindjes;
- Kopje e letërnjoftimit;
- 2 fotografi (formati pasaportë)

Studentët të cilët aplikojnë në studimet Master, i bashkëngjisin aplikacionit:

- Diplomën ose certifikatën e fakultetit (të noterizuar)
- CV
- Certifikatën e lindjes
- Kopjen e letërnjoftimit
- Dy foto

038/045- 500 878 : 029-230-555

044/ 049/ 048- 500 – 878



KOLEGJI - COLLEGE

BIZNESI

Prishtinë

Rr"Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, Ulpianë 10000 Prishtinë – Kosovë, www.kolegjobiznesi.com, info@kolegjobiznesi.com

Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: 30.05.2025, të Kolegjit “BIZNESI” Prishtinë:

SHPALL KONKURS PËR PRANIMIN E STAFIT AKADEMIK

I. PROFESORA

1. **Dy (2)** mësimdhënës në programin – **Ekonomik,**
2. **Dy (2)** mësimdhënës në programin – **Juridik,**
3. **Dy (2)** mësimdhënës në programin - **Menaxhimi i Emergjencave,**
4. **Një (1)** mësimdhënës në programin – **Shkenca Kompjuterike,**

Zgjedhja e personelit akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat e Statutit të Kolegjit Biznesi.

Për vendin e punës mësimdhënës, kandidatët e interesuar duhet të kenë të përfunduar doktoratën në lëmin përkatëse dhe punime në revistat si SCOPUS dhe WEB OF SCIENCE.

Njohja e gjuhës angleze apo e ndonjë gjuhe tjetër të huaj është përparësi për aplikantët.

Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet ti paraqesin këto dokumente: Kërkesën me biografi (CV), Kopjen e diplomës përkatëse të noterizuar (vërtetuar), Certifikatën e lindjes, Kopjen e letërnjoftimit.

Kandidatët që kanë doktoruar jashtë vendit duhet të sjellin edhe dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i, në të kundërtën, dosja e aplikantit do të konsiderohet e pakompletuar.

Konkursi mbetet i hapur nga **18.06.2025 deri më 30.06.2025.**

Paraqitja e dokumenteve: Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, 10000 Prishtinë, Kosovë ose përmes e-mail: info@kolegjobiznesi.com

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në web faqen: www.kolegjobiznesi.com

Aplikacionin mund ta shkarkoni në ueb faqen: www.kolegjobiznesi.com ose mund ta merrni në zyrat e Kolegjit Biznesi.



Gjeje PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejepuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Rigon Pacolli nga Prishtina, shpall të pavlefshme dëftesën e klasës -X-, të lëshuar nga Gjimnazi “Eqrem Çabej”, Prishtinë.

- Valdrin Muhadri shpall të pavlefshme dëftesën e klasës -X- të lëshuar nga Gjimnazi "Hajdar Dushi", Gjakovë.

- Nebi Muhadri nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e klasës -X- të lëshuar nga Gjimnazi “Hadar Dushi”, Gjakovë.

- AGON PERQUKU, shpall te pavlefshme dëftesën e klasës 10 dhe 11 te SHMLM “DR. XHELADIN DEDA”.

- ARJETA BAJRAMI, shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën e SHMLM “DR. XHELADIN DEDA”.

- RLIND REXHEPI, shpall te pavlefshme dëftesën e klasës 10 dhe 11 te SHMLM “DR. XHELADIN DEDA”

- KI PECI SHPALL TE PAVLESHME CERTIFIKATEN E LESHUAR NGA QENDRA PER AFTESIM PROFESIONAL MITROVICE, KURSI NDERTIMTARI NR I CERTIFIKATES 506-2004.

- FIDAN FERIZI, SHPALLTE PAVLESHME DIPLOMEN E SHMLT “ARKITEKT SINANI”.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

